




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



PROCES VERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **22.11.2024**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, z. **Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 22.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, z. **Smajl Latifi**, Nënkyetar z. **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtore të drejtive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje **të njëmbëdhjetë** me radhë të vizit **2024**, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/2024 Nr. i faq/Br.str./No.pg 2

Data/Datum/Date 26/11/2024

REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarje të parcelave në ZK- Kramovik, P- 00760-1 dhe ZK Petkoviq (Gur i Kuq), P-00185-0, 01122-0, 01124-1 dhe 01124-2;**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P- 00268-1 ZK-Hoçë e Madhe;**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00268-1, ZK Hoçë e Madhe;**
- 7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.253/24, i datës 24.9.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës dhe vendimin 01 Nr.254/24, të datës 24.9.2024, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;**
- 8. Shqyrtimi i informatës për punën e bujqve të komunës së Rahovecit.**

Shtesë:

- 9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesëve të parcelave në Kramovik dhe Gur i Kuq;**
- 10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale - Hotel Park.**

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, ky është rendi i ditës bashkë me dy pikat shtesë, a ka ndonjë diskutim?

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, të gjithë që jeni prezent. Fillimisht, ju kërkoj falje për vonesën e grupit të asambleistëve të LDK-së. Sa i përket propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të pronës komunale - Hotel "Park Plaza", janë çështje që nuk mund të jenë sot. E para, dje ka ardhur materiali për sot dhe besoj që nuk është urgjente që të jetë kaq shpejt. E dyta, nuk është e logjikshme ta shkëpusë

fund, nëse nuk ka zbatim të kontratës, atëherë kontrata shkëputet. Si grup i asambleistëve mendojë që kjo kontratë mund të shkëputet lirshëm nga kryetari i komunës, hiç pa u shfuqizuar ky vendim për rekomandim. Është vlerësuar prej një komisioni që ka shkelje të kontratës dhe asambleja mund të marrë vendim për shpallje në ankand dhe t'i propozojë emrat për komision për procedurat tjera të dhënies në shfrytëzim. E kam parë që komisioni e ka bërë vlerësimin goxha herët, kjo pikë është dashur të jetë edhe në mbledhjen KPF-së, përmes së cilës të vije në seancë të rregullt dhe asamblesitët të kenë kohë që ta bindin vetën dhe të thonë që "kjo është në rregull"!.

Mirsad Shala: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar asambleistë! Në pyetjen e asambleistit Burim Krasniqi: Në momentin që kuvendi e jep në shfrytëzim një pronë të paluajtshme të komunës, pikë së pari merret vendimi në kuvend, pastaj obligohet kryetari i komunës që ta nënshkruajë kontratën me përfituesin që është më i mirë në ankandin publik. Këtu, ky rekomandim ka qenë faktikisht joligjor, sepse është dashur të merret vendim për dhënien në shfrytëzim. Nuk ka të drejtë kuvendi të rekomandojë. Faktikisht, duhet të shfuqizohet ky vendim, (kërkoi falje, është rekomandim), sepse aty thuhet: Pika 3, kuvendi i komunës i rekomandon kryetarit të komunës që të lidhë kontratë për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme me operatorin. Kështu që, faktikisht duhet të shfuqizohet ky vendim i kuvendit dhe pastaj kryetari i komunës obligohet ta shfuqizojë kontratën. Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 22, mbikëqyrja e kontratave dhe rregullojra për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 27 thotë: Nëse investitori edhe pas masave të shqyrtaura nuk ndërmerr masa për realizimin e kontratës, kryetari i komunës obligohet që ta njoftojë kuvendin e komunës, së bashku me rekomandimin për shfuqizimin e kontratës. Pika 5 thotë: Kuvendi i komunës pas njoftimit të pranuar nga kryetari, shfuqizon vendimin përkatës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Paragrafi 6 vazhdon dhe thotë që pas shfuqizimit të vendimit të kuvendit, kryetari i komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës.

Burim Krasniqi: Nuk kemi vendim për dhënien në shfrytëzim, çka shfuqizon kuvendi në këtë rast? E dyta, pika 3 e vendimit: Obligohet që t'i shlyej obligimet komunale. A ka autoritet kuvendi që t'i kërkojë shlyerjen e obligimeve, ku ai ka obligime dhe nëse ai ka obligime, kuvendi nuk ka nevojë ta obligojë. Pika 3 është e paarsyeshme në këtë vendim ku jepet rekomandimi për shfuqizim.

Mirsad Shala: Faktikisht ne e kemi diskutuar këtë pikë me kryetarin dhe drejtorin. E kuptoj që këto janë obligime komunale dhe mund edhe mos të figurojë në kuvend, sepse ato janë obligimet që operatori i ka në raport me komunën. Mund edhe ta largojmë këtë pikë, mirëpo, proceduralist jemi në rregull, sepse jemi duke e shfuqizuar këtë rekomandim dhe nuk kemi vendim tjetër që hoteli-prona është dhënë në shfrytëzim.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët, përfaqësuesit LMT-së, OSBE-së, mediat dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Pajtohem plotësisht me diskutimin e Burimit, por edhe me sqarimin që na dha kryetari dhe përfaqësuesi ligjor. Në një mënyrë apo tjetër, të gjithë e kanë të drejtën e vet. Ajo që më shqetëson mua është: Ai operator ekonomik është shumë gjatë duke operuar aty dhe e din komuna sa ka qenë efikas ndaj obligimeve. Është bërë praktikë e keqe, që në çdo mbledhje kemi pika shtesë. Kjo praktikë nuk ka qenë përpara. Unë e kuptoj që nëse është ndonjë urgjencë nga qendra, por jo çdo mbledhje të kemi pika shtesë. Unë nuk jam për bllokim të kësaj pike, por jam për procedura të rregullta. Burimi e tha shumë qartë, këtë pikë nuk ka urgjencë ta shqyrtojmë sot, mund ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës më mirë. Unë nuk jam pro asaj që të mbështeten operatorët që nuk i kryejnë obligimet dhe që nuk janë efikase. Pse kryetari i komunës bashkë me kryesuesin e drejtorët, nuk e ka menduar këtë punë para 1, 2 apo 3 muaji, apo edhe kur kanë filluar punimet në shesh? Ta kemi materialin edhe në KPF, ta procedojmë ashtu siç duhet, ju si ekzekutiv dhe ne si kuvend.

Kryetari: Sa i përket vonesës, të premten ka ardhur përgjigja nga operatori përmes avokatit, rreth orës 16:00. Ju tregova që kemi më shumë se 6 muaj që negociojmë dhe pritet tonë kanë qenë që shkëputja e kontratës të jetë me marrëveshje. Ka qenë edhe një aneks kontratë për nevojat e parkingut, të cilën e kemi shkëputur me marrëveshje dhe tanë është bërë parkingu nëntokësor. Ju thash, ky proces është filluar më herët, por rezultatet e këtij procesi kanë ardhur të premten. Bëhet fjalë për shfuqizimin e rekomandimit që dikur komuna ia ka dhënë dhe tanë vendim që ky rekomandim të

i vonuar. E di që është dashur të jetë edhe në KPF, por, ju tregova saktësishët që me e-mail nga ata ka ardhur të premten – përgjigja përfundimtare që ne nuk jemi të gatshëm për nënshkrimin e përbashkët, që kontratën ta shkëpusim me marrëveshje. E ftoj kryesuesin ta vendosë në votim, nuk është ndonjë krim i rëndë edhe ta shtyjmë, por, shtyrjet nuk janë duke na ndihmuar fare. E respektoj shumë operatorin, mos neve na kanë ikur mysafirët prej atij hoteli. Hoteli në fjalë nuk e ka minimumin e kushteve.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Fillimi siht dua ta lexoj nenin 39 të rregullores, për t'i shuar paragjykimet. Kryesuesi I mbledhjes vendosë për renditjen e atyre që e kërkojnë fjalën, pasi ta marrin fjalën ata duhet t'i përmbahen çështjeve aktuale të mbledhjes. Kryetarëve të grupeve u jepet përparësi gjatë diskutimit.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përvendosetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Për korrektësi, këtu mundohem ta jap një kontribut. Kontrata në mes kryetarit dhe kontratëmarrësit është bërë me 24.05.2013. Kur lidhet një kontratë, ajo lidhet me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta. Njëri prej kushteve të veçanta ka qenë investimi, në kohën 1-15 vite. Në kontratë, në kushte të veçanta investimi ka qenë 2.628.792€. Meqë unë me profesion jam edhe jurist, këtu është interesant, është nxjerrë një komision për të dalë në vend të ngjarjes dhe t'i evidentojuë investimet e firmës përkatëse. Vlera e investimit që është nxjerrë nga komisioni është 101.000€ në vitin 2022. Kontrata është lidhur në 2013 dhe deri në vitit 2022 janë investuar vetëm 101.000€, kjo i bie që zotëria në fjalë ka parashtruar fatura në vlerë prej 322.000€, të cilat nuk janë të arsyetuara. Nga ana ligjore, kontrata shkëputet në mënyrë të njëanshme kur nuk zbatohet ajo kontratë. Unë mendoj që, ne duhet ta rekomandojmë kryetarin që në mënyrë të njëanshme ta shkëpus këtë kontratë. Këtu u fol, bënë propagandë, sepse i kanë mësuar dy rreshtha nga ana ligjore duke thënë që operatori bën kërkesë për masa të sigurisë. A e dini që me bë kërkesë për masë të sigurisë, gjyqtari i procedurës paraprake, pa prova juridike nuk vendosë masë. Nëse ai bën padi, komuna ka të drejtë të bëjë përgjigje në padi dhe mos mendoni që nëse bëhet një padi, neve na mori pusi. Është mirë ta rekomandojmë kryetarin që ta pezullojë në mënyrë të njëanshme këtë kontratë juridike.

Kryetari: Po kërkoni detaje: Pishina nuk ka ndodhur, nxemja qendrore nuk ka ndodhur dhe shumë gjëra tjera, ashensori jo. Bëhet fjalë për një objekt jashtë standardeve. Cili nga ju ka shkuar për një kafe aty së fundmi? Ndoshëta nuk ka as kafe! Ujin e kafes gjithashtu e ka me ujë jo të Radoniqit. Prandaj them që “urgjenca” është kjo. Kjo nuk ka të bëjë me operatorin, sepse unë me operatorin nuk kemi probleme individuale, përkundrazi, investimi i planifikuar nuk ka ndodhur dhe aty nuk ndodh asnjë lloj aktiviteti.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Përvendosetje kryetar, përvendosetje për të gjithë! Jemi në pozitë të keqe, sepse edhe unë jam një farë operatori. E para, hipotetikisht po e votojmë rendin e ditës, por është përgjegjësi, që mos të them dikujt t'ia ndërpresim “bukën” dhe aktivitetin. Unë deri tani nuk e kam ditur se kush është operatori aty, sidoqoftë po e bëjmë në një seancë tjetër, ta kemi raportin më detajist dhe unë pajtohem me ty që kjo është shkelje e rëndë, prej 2.6 milionë në 100.000 investime, atëherë pse nuk e keni dërguar te përmbaruesi?

Kryetari: Nuk shkojnë obligimet për investime te përmbaruesi Sefë, mos bëni hajgare! Mos harroni, unë kam temperament, por nuk jam nervoz. Operatori ka obligime që krijohen në baza mujore, të cilat duhet t'i paguajë. Aty nuk bëhet fjalë që dikush dikujt ia merr bukën e gojës, aty nuk ka punë, nuk ka punë, a e kuptioni!? Plani nuk është përbushur as në minimum. Sipas inspektoratit, ai objekt duhet të mbyllët, sepse nuk ka kushte minimale higjieno-sanitare. Unë e jap nënshkrimin për shkëputje të kontratës, mirëpo, nuk mund të amnistohet kuvendi nga ky proces. Nuk është që keni mungesë të informatave rreth gjendjes aty. Ju e votoni dhe kryetari e merr autorizimin.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Atëherë, pas diskutimeve të shumta, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota pro, 6 kundër dhe 6 abstenim, kjo pikë futet në rend dite. E vendosim në votim pikën tjetër shtesë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që unanimisht votohet edhe pika e dytë shtesë. E vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që me 26 vota pro, asnjë kundër dhe 1 abstenim, votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

diskutohet në grupe dhe merret një vendim. Ju nuk po na leni hapësirë as të diskutojmë me grupet tona, sepse pas orës 16:00 vjen emaili me pika shtesë. Nuk është rastësi nëse kjo gjendje vazhdon muaj për muaj. Kemi mirëkuptim nëse MAPL thotë që duhet t'i bëjnë disa veprime në shpejtësi, por nëse çdo herë e kemi këtë gjendje para aktit që ne të dalim keq para bizneseve dhe para qytetarëve, atëherë nuk është në rregull.

Drilon Mustafa: Përshëndetje kryesues, nënkytar, drejtorë, kolegë të nderuar. E kam një shqetësim në lidhje me dy banorë të fshatit Pastasel. E di që komuna, obligimet ligjore ndaj tyre i ka kryer. Ata e marrin një rrogë, por ai që e ka marrë kujdestarinë nuk kujdeset për ta. Këta dy persona, nuk kanë trajtim mjekësor dhe gjumin e bëjnë nëpër rrugë. Duke pasur parasysh që po futemi në stinën e dimrit, e lus Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale që të merret me këtë rast dhe të paktën t'i dërgojë ekipet mobile shëndetësore për vizitë. E kam diskutuar edhe me QPS-në dhe më kanë thënë që nuk kemi mundësi t'i dërgojmë në Qendrën Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik-Psikiatrik në Shtime, sepse dyer janë të mbyllura. Mendoj që si komunë është shumë e arsyeshme që të kontribuojmë në këtë rast.

Defrim Kafexhiu: E kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrës dhe Gjeodezisë dhe për nënkytarin e komunës, nëse kanë informacion për çështjen e trafos në rrugën "Vellezërit Frashëri". Ku janë procedurat dhe si është forma që procedura të përshpejtohet? Një pyetje tjeter: Te shtëpia për qëndrim ditor për të moshuar, si është duke funksionuar? Sipas informatave që i kemi, diçka nuk është duke funksionuar!

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit. Në seancën e kaluar e kam bërë një pyetje për drejtorin e arsimit dhe nuk kemi marrë përgjigje, pyetja ka qenë rrëth kontratës për furnizimin me pelet dhe dru në shkolla, sa është vlera. Për drejtorin e urbanizmit, rrëth nënshkrimit të aneks-kontratës për rregullimin e shtratit të lumbit Hoçë e Madhe – Brestoc, Hoçë e Vogël – Krushë dhe Nagac. Në fshatin Brestoc besoj që jeni në dijeni për atë pjesën e kanalizimit, që një pjesë e lumbit përsëri derdhet në shtratin kryesor, a është i përfshirë në projekt ky rregullim?

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Dëshiroj ta pyes drejtorin e shërbimeve publike: Më duket që është duke u punuar projekti i kanalizimi prej Hoçës së Madhe deri në Drin. Është nisur në Krushë të Madhe dhe tanë punimet janë duke vazhduar lartë. Pyetje ime është që, pse nuk e kanë vazhduar nga aty dhe të shkojnë lartë, por e kanë përfunduar një pjesë poshtë, tanë janë lartë dhe nëse ndoshta ia nisin në mes. Ku është arsyaja?

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj ta pyes drejtorin e urbanizmit, pse janë ndërprerë punimet në "Grape land" apo "Grape city"? Në fillim të punimeve ka qenë me vrull, ndoshta pse ka pasur kundërshtime, ndërsa tanë puna ka stagnuar. Pse janë ndërprerë punimet? Apo ndoshta e keni ndërruar mendimit për t'ia ndërruar emrin, fakt ky që do të më kishte gjuar.

Sinan Kryeziu: Në kuvend është folur disa herë për problemen e bujqve të komunës sonë. Realisht për subvencionet e tyre dhe për dëmet që janë shkaktuar nga shiu në të mbjellat e tyre. Jemi në fundvit dhe është e dhimbshme që ende nuk janë marrë subvencionet nga ana e Ministrisë së Bujqësisë. Dua ta informoj qytetarin: Drejtoria e Bujqësisë në komunën tonë, buxhetin për investime kapitale për vitin 2024 e ka 1.055.000€, ku janë të planifikuar: rregullimi i rrugëve fushore, mirëmbajtja e tyre si dhe kanalet e grumbullimit të ujërave. Vlen të theksohet se, buxheti i Drejtorisë së Bujqësisë është shpenzuar mbi 92% dhe kanë mbetur pa u shpenzuar 80.000€ e që janë lidhur kontrata të reja, për shkak të kërkësës së qytetarëve për rrugë të reja fushore. Ministria e Bujqësisë për investime kapitale për vitin 2024, i ka të planifikuar 4.544.000€ dhe fatkeqësisht, asnjë euro nuk e ka ndarë për ta deleguar këtu në vetëqeverisje, në drejtorinë përkatëse në komunën tonë, as për Komunën e Suharekës. Para vetes e kam një kontratë, e cila është lidhur më 29.10.2024 me nr. të protokollit 3644/3, e ritheksoj, kjo kontratë është lidhë më 29.10.2024, me titull: Dizajnimi dhe mbikëqyrja e projektit për rehabilitimin e rrjetit rrugor në zonat vreshtarë të Kosovës. Këta u kanë dhënë një kontratë firmave të caktuara në vlerë prej 9078€ dhe këta me pak fjalë të tregojnë se si shtrohen rrugët dhe ku shtrohen ato me zhavorr. Vlera e këtij kontestit nga ana e ministrisë është 345.000€. Nga kjo vlerë, të dedikuara për Komunën e Rahovecit janë 250.000€. Ne e dimë shumë mirë procedurën se si jepet një kontratë e deri në ekzekutimin e saj. Jemi në dimër dhe ky i miri që e

është në privatizim nga “Stone Castle”, historikun e parcelës do t’ju bëj pa pagesë. Në pyetjen e Defrimit: Ka vendim preleminar për parcelën në fjalë, ka interes të përgjithshëm dhe është njoftuar KEDS-i dhe është në proces të vlerësimit.

Burim Krasniqi: Drejtor, ju kërkoj mirëkuptimin, kur e bëj pyetjen të përgjigjesh në pyetje. Në asnjë moment nuk e kam thënë dhe nuk e kam të drejtën ligjore ta kontestoj dhe t’i jap opinion procesit të privatizimit. Në takim më kanë thënë që kanë bërë kërkesë për ta marrë historiatin për një parcelë, na kanë thënë që nuk bën, sepse nuk jemi pronarë, pikë. Më thanë e kemi përgjigjen me shkrim, e pashë përgjigjen me shkrim. Në atë kontest, të kërkova mirëkuptimin, në aspektin ligjor duke mos rrezikuar as ti, as zyrtari përgjegjës në departamentin tënd, t’i jepni historiat familjar atyre dhe nëse jo për parcela, për familjen. Meqenëse ti the që jam i gatshëm, besoj që qytetarët e kanë parë dhe t’i njoftojnë ata që së paku ta shohin veten se ku janë në atë proces.

Nënkyetari: Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë, drejtorë, të pranishëm. Njerëzit i kanë punuar ato toka, deri sa ka ardhur vendimi i pronarit aktual mbi bazën e një procedure të privatizimit, që i takon një organi tjeter. Te historiku i parcelave, ju e përmendët që ka padi në gjykatë ndaj kompanisë “Stone Castle”, prej pronarëve.

Burim Krasniqi: Jo jo, nuk e kam thënë ashtu!

Nënkyetari: Kështu e kam të regjistruar këtu, do ta verifikoj. Nëse ka “padi” gjykata automatikisht do ta kërkojë historikun e parcelës, pavarësisht autorizimit të pronarit. Ne si institucion kemi përgjegjësi publike t’i takojmë të gjithë ata banorë, t’i dëgjojmë shqetësimet e tyre dhe secilën punë që e ka komuna, ne jemi aty për punë. Nëse fitohet ky “kontest” në gjykatë, komuna e ka për obligim t’i kryej transaksionet juridik prej një pronari në tjetrin.

Burim Krasniqi: Nënkyetar, po e them zyrtarisht, në asnjë moment nuk kam thënë që ka kontest gjyqësor, sepse nuk e di. Nuk kam informatë nëse ka padi apo jo, sepse nuk jam i thirrur për këtë punë. E dyta, jam i vetëdijshëm që pronarët në trashëgiminë e tyre e vërtetojnë që dikur kanë qenë trashëgimtarë, ata nuk kanë punë me “Stone Castlen”, por me shtetin dhe AKP-në. Kërkesa e vetme ishte që ata ta marrin historiatin.

Nënkyetari: Drejtori e potencoi që, secila palë që shpreh interes në lidhje me problematikën e shtruar nga ti, do të pajiset me historikun dhe rrjedhën e parcelës, prej vitit 1953. Unë kam qenë 3 vjet drejtor i Kadastrës dhe Pronës dhe në secilën shitje që është bërë ndërmjet AKP-së dhe pronarit (operatorit), në kontratë është një paragraf aty që thotë: Për çdo pretendim të një pale tjetër në një të ardhme të afërt, apo larg, AKP-ja nuk merr përgjegjësi për atë pronë, d.m.th ti ballafaqohesh si pronar ose si blerës.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, asambleistë dhe pjesëmarrës. Te pyetja e Lirigzonit: Nuk është anekskonratë, por është konratë e rregullt që është nënshkruar nga komuna tani. Ka qenë një konratë, por, ministria e tanishme e ka ndalur një momerandum, i cili ka qenë i nënshkruar dhe nuk e kanë financuar. Tani komuna ka arritur të nënshkruajë një konratë dhe operatori është duke i bërë punimet, si dhe shumë shpejt do të vazhdojmë me vendosjen e kolektorit të ri në atë pjesë. Te Rasim Fazliu: Në Krushë të Madhe është konratë tjetër, që vazhdon nga pjesa e kësaj kontrate deri te lumi Dri dhe me buxhetin e vitit të ardhëm do të fillojnë punimet aty ku kanë mbetur. Sa i përket pyetjes së Merisës, punimet në Grape City, jo Grape land, janë duke vazhduar. Operatori nuk është në terren, sepse është duke e punuar konstrukcionin metalik, i cili besojmë që do të vendoset brenda këtij viti.

Nënkyetari: Meqenëse asambleisti Ilir Pallqa nuk është aty dhe nëse më ishte drejtuar mua “hipotetikisht” për një nënkyetar të një komune tjetër “hipotetike”, do t’i përgjigjesha kështu dhe nuk kam autorizim të përgjigjem në këtë pyetje. Te asambleisti Bejtullah Deliu sa i përket pikave shtesë, këtu jam 1 milion % dakord me juve. E di këtë punë, sepse vet kam qenë asambleist, por, ja që ndodhin në shumë raste. Te Drilon Mustafa: Ata i njoh dhe realisht e ligjërisht duhet ta kenë një kujdestar. Komuna në atë se çka mund t’i ndihmojë, besoj që jemi në vijë. Te asambleisti Defrim Kafexhiu: Shtëpia e të moshuarve është e hapur, çdo ditë prej 08:00 – 16:00, me transport të siguruar dhe gjithashtu janë edhe shujtat. Nëse nuk ka interesim, nuk e di çfarë mund të bëj, përndryshe çdo gjë funksionon.

Avni Morina: Faleminderit kryesues! Përshtendetje për të gjithë. Një pyetje e pata nga kuvendi Lirigzon Kastrati për çmimin e lëndëve ngrohëse për dimër, për pelet dhe dru. Ju kërkoj falje që më ka ikur kjo pyetje. Sipas kontratës së nënshkruar, çmimi për një ton pelet është 370€, ndërsa çmimi për një metër kub dru është 84,80€. Kontrata e peletit

mënyrën e vlerësimit të pronave për tatimin në pronë. Duhet të shtohet një segment në kuadër të ueb-faqes së komunës, ose ndonjë alternativë tjeter që qytetarët të informohen se si po bëhet vlerësimi i pronave të tyre.

Burim Krasniqi: Drejtor, e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe përsëri po e shprehi të njëtin shqetësim. Te neni 9 i ligjit 08-L/224 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit 06/L-005 për tatimin në pronë, paragrafi 4 thotë kështu: Kuvendi i komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufij tatimor, sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri më 30 nëntor të vitit paraprak për vendosjen e tatimit. Shkalla tatimore e përcaktuar nga komuna duhet të ketë trend progresiv. Në paragrafin 3 i kemi 5 vlera të detyrimeve tatimore, në propozim-vendim e kemi vetëm për një, vetëm për 3.1. A e vlerësoni edhe ju që është nevoja që të përfshihen edhe këto norma tjera, sepse mund të vije momenti që mund ta bëjmë plotësim-ndryshimin e vendimit, sepse mund të ketë prona që janë mbi 100.000€ apo mbi 500.000€, që do të tatohen edhe sipas paragrafit 3.3 dhe 3.2 të paragrafit 3, të nenit 9. Shqetësimin që e kam thënë në KPF që tabela duhet t'i ketë edhe këto norma tjera tatimore, besoj që jam në rregull duke e parë shpjegimin e paragrafit 4 të nenit 2, që e bën shkallën tatimore të plotësim-ndryshimit të nenit 9. A jemi në rregull në këtë kuptim? Si grup i asambleistëve të LDK-së, rekomandojmë që normat tatimore sa i përket njësive rezidenciale, parcelave dhe objekteve, të shkonit në minimumin e mundshëm, të ketë zbritje në kuptimin e trajtimit të barabartë për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Rahovecit. Të ketë një zbritje, qoftë edhe simbolike, por ta përcjellim një sinjal pozitiv që, Komuna e Rahovecit në këtë rast asambleja i trajton të gjithë drejt.

Afrim Limani: Nëse të kujtohet, vitin e kaluar ne e kemi zbritur normën tatimore për objektet rezidenciale dhe parcelat e tyre. Nga vlera 0.16% për objekte, i kemi zbritur në 0.15%, ndërsa për parcela 0.12% dhe kjo është zbritja më e mundshme dhe më e madhja që e kemi arritur në favor të interesit të qytetarëve. Rezultati i kësaj zbritje ka reflektuar kështu: 16.000 tatimpagues në 2023, prej tyre 7808 kanë përfituar zbritje zero dhe janë eliminuar nga tatimi, kanë ngelur 8202. Zbritje më të madhe nuk ka. Te objektet e kemi bërë një analizë të mirëfilltë dhe kemi dalë me këto përqindje, sepse kanë ngelur të tatohen edhe 8202, që i bie rreth 50% janë eliminuar. Konsideroj që ky është maksimumi i zbritjes te pronat rezidenciale. Sa i përket asaj që the, për vlerësimin e zonave në nivel jo të përshtatshëm, këto kompetenca i ka vetëm departamenti i tatimit në pronë. Burim, kur e bëra prezantimin nuk ishe i pranishëm, sepse ndoshta nuk do të ma kishe bërë këtë pyetje. Sipas nenit 9, deri më 30 nëntor duhet ta propozojë normën tatimore. Neni 9 përmes paragrafëve e përcakton se për cilat norma tatimore bëhet fjalë. Paragrafi 3.1, pronat deri në 100.000€ e kanë normën 0.10%-1%. Në këtë rast, propozimi ynë referohet pikërisht te paragrafi 3.1 dhe 90% të pronave i përkasin këtij paragrafti.

Burim Krasniqi: E kemi diskutuar disa herë, nuk jam jurist e as ekonomist, jam inxhinier me profesion. Paragrafi 4 thotë: Kuvendi i komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufij tatimor, sipas paragrafit 3 të këtij neni dhe nuk thotë, sipas paragrafit 3, nënparagrafit 3.1, por i përfshin krejt.

Afrim Limani: Te paragrafi 4, do të thotë: mbi 1 milion është 40%. Kuvendet komunale kemi të drejtë t'i caktojmë deri në 1%, mirépo nuk e bëjmë atë veprim, sepse minimumi i mundshëm është 10% dhe në këtë rast e përfshin paragrafi 3.1. Një informatë tjeter është që në draft-buxhet për vitin 2025, të gjitha normat do të kenë rënje prej 0.10 deri në 1%. Afati kohor është deri më 30 nëntor dhe ne duhet ta trajtojmë në bazë të ligjit në fuqi.

Defrim Kafexhiu: Drejtor, e kam një kërkesë: E përmenda edhe një herë që sipas udhëzimit administrativ, njësitë rezidenciale të objekteve sipas këtij propozimi, paguajnë më shumë tatim në bazë të vlerës që përcaktohet nga departamenti i tatimit në pronë se njësitë industriale. Kjo është diskriminim për njerëzit që, një shtëpi banimi të paguajë tatim në pronë më shumë sesa një fabrikë. Unë jam për ulje të përqindjes së normës tatimore për njësitë rezidenciale të objekteve, por, të kompensohen që komuna mos të penalizohet me këtë zbritje. Të rritet përqindja për njësitë komerciale dhe industriale, sepse janë objekte fitimprurëse dhe bëjnë biznes, ndërsa shtëpitë e banimit janë jetike. Është e padrejtë që shtëpitë e banimit ta kenë normën tatimore më të lartë, sesa njësitë komerciale dhe industriale. Te mënyra e vlerësimit, aty thuhet që te mbledhja e të dhënavë bëhet nga zyra komunale, bashkë me atë të ministrisë, i mbledhin të dhënat prej kontratave të shitblerjes. Si komunë, ose si Drejtori e Financave është dashur ta bëni edhe një shfrytëzim i hapësirave ligjore te klasifikimi i këtyre informatave, që të merren kontratat që kishin derivuar një përqindje më të ulët të tatimit

Defrim Kafexhiu: Për çudi nuk po vërehet shumë mungesa e kryetarit, kjo ndoshta se shumë pika po prezantohen nga drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër. Drejtor, destinimi i pronës që po jepet në shfrytëzim, a është i cekur në vendim apo jo? Për çka po jepet në shfrytëzim kjo pronë?

Afrim Oruqi: Sipas PZhK-së, kjo sipërfaqe është e destinuar për prodhim tretësor, shërbim tregtar, shërbim me shumicë dhe pakicë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Atëherë, nëse nuk keni diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është “për” këtë pikë?... Kundër?... Abstenim?... Me 18 vota “për” dhe një votë kundër, votohet edhe pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00268-1, ZK Hoçë e Madhe;

Afrim Oruqi: Sipas ligjit, e kemi për obligim të formojmë një komision, i cili do t'i zhvillojë procedurat e parapara që atë tokë ta japim me qira, 40 ari për 15 vjet. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 2 anëtarë nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi: Fillojmë me propozimet.

Hasan Përboqi: AAK, Feriz Thaqi!

Edonë Kryeziu: LDK, nuk kemi propozim!

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk kemi propozim!

Merisa Sharku: LVV, Defrim Kafexhiu!

Ilir Pallqa: I pavarur, nuk kam propozim!

Kryesuesi: Atëherë, dy përfaqësues nga kuvendi i komunës janë: Feriz Thaqi (AAK) dhe Defrim Kafexhiu (LVV). Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (19) votohet përbërja e komisionit.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.253/24, i datës 24.9.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës dhe vendimin 01 Nr.254/24, të datës 24.9.2024, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale:

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni propozimin për shfuqizimin e dy vendimeve, të miratuara nga kuvendi komunal në seancën e shtatorit. Fjala është përvendimin 01 Nr.253/24 dhe përvendimin 01 Nr.254/24, për lokalet zejtare. Nga ministria është konfirmuar që duhet të shfuqizohet ky vendim, për shkak se prona e cila shfrytëzohet aktualisht nga stacioni i autobusëve, Komuna e Rahovecit nuk ka të drejtë t'i jep në shfrytëzim, sepse aktualisht janë në shfrytëzim. Nga MAPL është kërkuar që ankandi publik të ndiqet nga stacioni i autobusëve.

Burim Krasniqi: Faleminderit shumë kryesues! Kur flasim, ndonjëherë është mirë të na dëgjoni edhe pse jemi opozitë. Kur e keni nxjerrë vendimin për dhënien në shfrytëzim, e kemi thënë si LDK që nuk ka të drejtë komuna t'i jep në shfrytëzim hapësirat e ndërmarrjes publike. Tani kemi ardhur në situatë ku duhet ta shfuqizojmë vendimin. Për çdo eventualitet, lexojeni procesverbalin e seancës së kaluar. Përndryshe, shfuqizimi i këtij vendimi është obligim ligjor dhe ne e përkrahim.

Mirsad Shala: Faleminderit kryesues! Unë jam i obliguar ta mbroj tezën tonë. Këtu edhe ministria ka bërë gabim. Neni 19, paragrafi 5 i ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, thotë: E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te pala e tretë, kështu që personi i dytë është realisht stacioni i autobusëve. Pyetje është: A ka të drejtë stacioni i autobusëve si shfrytëzues t'ia jep pronën personave të tretë? Gjatë konsultimeve që i kemi pasur me MAPL, nuk kemi marrë përgjigje konkrete, duke thënë që nuk dimë as ne si të veprojmë.

Burim Krasniqi: Dëgjomë, zyrtar ligjor! Unë nuk them asgjë më shumë se sa kanë shkruar ata, çka të kanë thënë kështu, unë nuk e di. Me ligjin përmenaxhimin e ndërmarrjeve publike, komuna nuk ka të drejtë të bëjë as investim. Mund t'ia bartë mjetet ndërmarrjes publike dhe ajo ta kryej investimin, eventualisht nëse lidhet ndonjë memorandum mirëkuptimi

Defrim Kafexhiu: Nuk ka lidhje që MAPL-ja e ka kthyer në rishqyrtim. Kuvendi me shumicë votash mund të vazhdojë përsëri në këtë formë, nëse ju e matni rrezikshmérinë e panalizimit sipas legjislativit, atëherë mund të vazhdojmë. Esenca është që këto lokale t'i kalojnë qytetarëve në shfrytëzim dhe nëse drejtori thotë që ata kanë leje e të gjitha këto, në certifikatë tregon se kush është titullari. Nëse titullar është stacioni i autobusëve, atëherë drejtori le ta hap ankandin dhe le t'i jep me qira lokalet. Nëse në rregulloren e stacionit nuk përcaktohen hapësirat e reja që janë ndërtuar, atëherë është mirë që bordi i stacionit ta ndryshojë rregullore.

Merisa Sharku: Drejtori tha, Merisa e din! Në këtë rast nuk e di! Pse është dashur kaq shumë të “pshtjellet” puna kështu? Stacioni prej fillimit është dashur ta hap ankandin, pasi e paska këtë mundësi, sepse është palë e parë.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! A është e mundur që në formë xhentëlmene, bordi i stacionit t'ia mundosojë komunës që komuna ta shpallë ankandin, me arsy që ata nuk kanë kapacitet. A kanë të drejtë ligjore?

Mirsad Shala: Interpretimin e ligjit e bën organi i cili e ka nxjerrë ligjin. Ne vetëm jemi duke e lexuar atë se çka e thotë ligji. Në shembull konkret: Nuk është njëjtë sikur të jesh titullari i një prone, sikur shfrytëzues. Titullari ka të drejtë që lokalini t'ia jep me qira dikujt. Rasti i fundit, hoteli. Hotelin e ka marrë x zotëria dhe ai tash mund t'ia jep Mirsadit, jo, nuk e lejon ligji. Dhënia në shfrytëzim shkon përmes zyrës së prokurimit.

Kryesuesi: Pas diskutimeve të shumta, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota “për” dhe një votë abstenim, votohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i informatës për punën e bujqve të Komunës së Rahovecit:

Kosovare Gashi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, Arbër Zenuni, asambleistë, drejtorë të drejtorive, të gjithë të pranishëm. Unë jam Kosovare Gashi, zyrtare në Drejtorinë e Bujqësisë. Drejtori sot mungon dhe po e zëvendësoj për këtë prezantim. Sot, e kam për detyrë t'ju informoj për punën e bujqve në Komunën e Rahovecit dhe të Drejtorisë së Bujqësisë gjatë vitit 2024, janar – nëntor. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural janë sektorë që kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Ne si drejtori, përmes politikave tona i kemi ndihmuar bujqit, në mënyrë që t'i stimulojmë më shumë për punë. Aktivitetet kryesore që kryhen vazhdimisht janë: Vërtetimi për fermer, numri identifikues i fermerit, ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, vizitat në terren, vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësítë natyrore, faktori njeri dhe nga faktorët e tjera. Aktivitet tjetër është edhe Thirrjet nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë. Në çdo fillimvit e kemi edhe subvencionimin e qumështit dhe viçave për majmëri. Ne si drejtori e bëjmë pranimin e aplikacioneve, më pas dorëzohen në ministri për shqyrtim. Për 6-mujorin e dytë të vitit 2023, kanë aplikuar 91 blegtore, 1.709.950 L qumësht dhe 522 krerë të viçave për majmëri. Ndërsa, 6-mujori i parë i vitit 2024 është në muajin gusht. Ka qenë e hapur për viça, qumësht, për sasi të kilogramëve të grurit dhe për pleh artificial me 100€ për hektar. Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar 804 fermerë, me sasi të kilogramit 7.942.000 kg grurë. Sipërfaqja e aplikuar për pleh ka qenë 3935 ha. Numri i viçave 692 dhe sasia e qumështit 1.899.000 litra. Aktivitet tjetër ka qenë edhe vaksinimi i bagëtive, i cili ka filluar në vitin 2023, 2024 dhe do të vazhdojë në 2025. Janë vaksinuar gjithsej 1915 krerë lopë dhe 7500 dele janë furnizuar me barna kundër sëmundjeve dhe në krejt komunën janë vizituar 121 ferma blegtoriale. Është duke vazhduar aksioni për trajtimin e qenve endacakë. Ka qenë një marrëveshje me qendrën grumbulluese “Agro-Celina”, që gjatë vitit 2024 të furnizohen bujqit me kulturë të trangullit Kornishan. Me këtë marrëveshje është mbuluar plehërimi dhe riplehërimi, bashkë me pesticidet, mulqërimi dhe sistemin e ujites pikë – pikë. Si punë kryesore e Drejtorisë së Bujqësisë janë edhe subvencionet. Afati i aplikimit zakonisht është një muaj, por për shkak të numrit të madh të fermerëve aktivë, afatin e shtyjmë për 1 ose 2 javë dhe gjithashtu i mobilizojmë edhe 2 zyre të tjera, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc. Numri total i fermerëve që kanë aplikuar në vitin 2024 është 3099 fermerë dhe nëse bëjmë krahasim me vitin e kaluar, janë 20 fermerë më pak. Komuna e Rahovecit do të fitojë 6.190.000€ dhe 560.000€ më shumë se sa në vitin 2023, sepse fermerët kanë aplikuar për më shumë sipërfaqe. Grurë ka pasur 223 hektarë më pak, vreshtat 58 ha më pak. Rritje kemi në sektorin e perime-kulturës, 78 ha specia janë më shumë se sa në vitin e kaluar, qepë 48 ha më shumë, 70 ha patate më shumë, lakër 64 ha më shumë. Kryesisht, te perime-kultura i kemi 264 ha më shumë sesa vitin e kaluar. Rritje kemi shënuar edhe te kungulloret, sidomos te shalqiri me 182 ha më shumë.

filluar rregullimin e rrugëve fushore. A pritet që shumë shpejt të rregullore relaciioni i rrugës fushore, Hoçë e Vogël – Brestoc?

Hasan Përboqi: E kam një pyetje të përgjithshme. Krahasimisht me vitin 2023 dhe me vitet paraprake, a ka pasur rënje të sipërfaqeve të punueshme që kanë aplikuar për subvencione?

Kosovare Gashi: Sa i përket pyetjes së Hasanit, unë e ceka se ku ka pasur rritje dhe ulje. Në lavërtari, në misër dhe grurë ka pasur ulje. Vreshtat kanë pasur ulje 58 ha më pak. Në sektorin e perime-kulturës ka pasur rritje 78 ha speca më shumë, 48 ha qepë më shumë, 70 ha patate më shumë dhe 64 ha laker më shumë.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesëve të parcelave në Kramovik dhe Gur i Kuq:

Afrim Oruqi: Me kërkuesë të Ministrisë së Ekonomisë, bëhet fjalë për disa parcela në dy zona. Ju kemi paralajmëruar edhe në KPF, që fillimisht me këtë vendim po i shpallim me interes të përgjithshëm dhe pastaj, pas ligjshmërisë së aktit do t'ju kërkojmë pëlqimin për këmbim. Qëllimi ka të bëjë për interes të parkut solar.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk keni diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është “për” këtë pikë?... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota “për” votohet edhe pika e nëntë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit për dhëniën në shfrytëzim të pronës komunale - Hotel Park:

Kryetari: Besoj që e kemi biseduar jashtëzakonisht gjatë dhe substancialisht për këtë pikë të rendit të ditës. Është ndihmë për kryetarin dhe ekzekutivit të komunës, si rekomandim për shfuqizimin e kontratës sipas procedurave ligjore. Ju ftoj që ta akceptoni, sepse bëhet fjalë për një veprim të arsyeshëm, ligjor dhe profesional.

Merisa Sharku: Kompania në fjalë e ka kontratën deri në vitin 2028 për t'i kryer investimet rreth mbi 2 milionë. Nëse ky operator ka borxhe ndaj komunës, komuna ka të drejtë t'ia shkëpus kontratën menjëherë. Nëse ky operator nuk ka borxhe ndaj komunës, realisht për investime ka kohë edhe 3.5 vjet. Hoteli është në gjendje të mjerueshme dhe pothuajse i pashfrytëzueshëm në total. Komuna është dashur që paraprakisht t'i qëndrojë gati me kohë për presion për investime, që hoteli mos të vijë në këtë gjendje. Kompania ka të drejtë që ta shfrytëzojë objektin edhe për këtë kohë që i ka mbetur dhe të premtojë për investimet e veta. Nëse kryetari e shkëput kontratën me këtë operator, cili është plani tutje për këtë objekt?

Kryetari: Ne po flasim për një hap konkret! Informacion keni me bollëk dhe nuk ka nevojë për informacionet shtesë. Nuk ka shanse të investojë, nuk ka interesim, nuk ka dëshirë. Sa për dijeninë e juaj, komuna i ka qëndruar afër çdo herë. A do të ketë hotel aty apo jo, përsëri do të flasim këtu në kuvend. Besoj që duhet të jetë një objekt që është i harmonizuar me atë që do të ndodh në shesh. I kemi argumentet, që fatkeqësisht duhet të themi që janë në anën e komunës së Rahovecit. Them fatkeqësisht, sepse nuk ka qenë dëshira jonë kjo gjendje. Kemi objekte që i kemi dhënë në shfrytëzim dhe komuna nuk debaton më për to. Shembull e kemi “Urën e Shenjtë”, aty është tejkaluar plani investiv. Ndërsa, këtu te hoteli nuk ka plan apo ide të investimeve, sepse nuk ka dëshmuar që ka pasur ndonjëherë dhe nuk kemi kohë të presim më. Fakti që 12 vjet nuk ka investuar, është vështirë të besojmë që për 3 vjet do të ketë masa dhe hapa konkret në investime.

Sejfullah Sejfullahu: Faza e investimeve a ka qenë e planifikuar të bëhet, faza-faza?

Kryetari: Burimi ka qenë një nga anëtarët e komisionit. Nuk ka logjikë që të gjitha këto investime të pabërë, të bëhen në fazën e fundit. Shyperi Shala, më falni që po e përmendi me emër, po ky zotëria i ka përfunduar investimet para kohe. Investimet që i bën tutje, nuk janë kërkesa dhe detyrime në bazë të kontratës. Këtu nuk ka zotime që do të bëhet diçka. Krejt çka bëhet këtu, bëhet një lojë e ping-pongut, avokati e kryen punën e vet dhe natyrisht fillimisht ka thënë që a keni mundësi të shkruani që nëse e shpallni edhe një herë në ankand, ta marrë unë. Është normale që ashtu nuk guxojmë. Unë dua ta ruaj operatorin, sepse nuk do ta ngarkojmë me hipoteka të kaluara, nëse eventualisht nëse do të jetë diçka tjetër në ankand. Nëse ai futet në gjykatë me neve, ekziston mundësia që komuna ta padisë për mungesë investimesh. Prandaj, ne i kemi thënë që ta shkëpusim me mirëkuptim, sepse është më mirë. Çështjen e borxheve mund ta akomodojmë disi,

ta ngremë dorën e tani thua që unë kam përgjegjësi, përkundrazi, përgjegjësia është edhe e imja kur e votoj. Më duhet kohë të konsultohem me vetveten dhe me grupin tim se çka po veproj në rastet si kjo, që është më e prekshme dhe më madhore. Kryetar, i preke disa tema që nuk është në rregull të shprehesh ashtu. Unë jam pro ndërtimit edhe shumë më të mirë e sa më bukur dhe nuk jemi këtu që ta dëmtojmë edhe asnjë pëllëmbë toke në komunën tonë.

Kryetari: Nuk thash që ti e dëmton. Ne e kemi obligim që, në momentin kur e japim në shfrytëzim pronën e paluajtshme, ta rrissim vlerën e saj. Në këtë rast, e tregon qartë fakti që investime 2 milionë janë më pak.

Bejtullah Deliu: Kryetar, kur është nënshkruar kontrata që është lejuar ky, a ka pasur ndonjë plan amortizimi prej A deri në ZH? Kur duhet të investojë, sa të investojë. Nëse po, atëherë pse është toleruar qa shumë, e sot kjo nguti? Këtu është e paqartë!

Kryetari: Plot informacione u diskutuan në pikën e dytë, para se të futemi pika tjera. Ju lutem, këtu nuk ka hapësira për keqkuptime. Ai ka aplikuar me një plan, i cili ka vlera dhe ka pozicione, është projekt. Kontratën e kemi nënshkruar, unë si kryetari komune dhe ai si operator. Për këto 12 vjet është dashur që aty t'i kemi edhe 2 milionë euro më shumë. Tani i kemi 2 milionë më pak dhe në këtë mënyrë vonesat na bëjnë "fajtor", sepse nuk e kemi trajtuar pronën e komunës si duhet dhe njëkohësisht me vonesa, me vetëdije ose jo, jemi duke e penguar vazhdimin e shfrytëzimit të pronës. Para se të futemi në rend dite, ju thash që procesi i negocimit ka filluar shumë herët dhe pritet tona kanë qenë që kontrata të shkëputet me marrëveshje dhe mos të vendoset hiç në kuvend. Tani e ka angazhuar një avokat, i cili dëshiron të luan "ping-pong" me komunën. Jam i sigurt që komuna i ka të gjitha të drejtat, që sipas ligjit nëse operatori nuk e ka përbushur veç një pikë të kontratës, atëherë komuna ka të drejtë t'ia shkëpusë kontratën.

Merisa Sharku: Që vota jonë të jetë sa më legjitime, si kërkesë e kemi që të shkohet me marrëveshje dhe të paktën të qëndrojë ajo që prej fillimit të punimeve në shesh deri më tutje, në këtë periudhë kohore të mos obligohet operatori për borxhe që ai i ka. Nëse kjo vazhdon, atëherë edhe ne jemi pro.


Kryetari: Jam plotësish dakord me këtë që thua ti dhe me atë që tha Iliri, por, nëse ai vazhdon me përballje në gjykatë, atëherë nuk ka falje. Ju ftoj që me këtë koment ta votoni.

Ilir Pallqa: Kjo iniciativë e kryetarit është interesante, e guximshme, nuk është populliste dhe si komunë kemi nevojë të marrim kësi lloj iniciativa. E inkurajoj që të marrë edhe iniciativa tjera të kësaj forme. Për shembull të krijoj hapësirë përtrotuar te Haxhijaha.

Kryetari: Unë kam formuar komisione që do ta monitorojnë secilën pronë që jepet në shfrytëzim nga kuvendi i komunës dhe do të raportojnë në kuvend në baza periodike. E falënderoj Burimin që e ka kërkuar këtë gjë, por, kjo gjë ishte edhe praktikë ligjore. Ju falënderoj për debatin dhe ju ftoj ta votoni.

Kryesuesi: Pas diskutimeve të shumta, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota "për", 8 kundër dhe 1 abstenim, votohet pika e fundit e rendi të ditës. Ju falënderoj për vëmendjen, shihemi në mbledhjet e radhës. Urime festa e 28 Nëntorit!

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I :


Arbër Zenuni

